

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5845  
E hënë, 5 gusht 2019  
çmimi 0.40 €

Në Klinikën e  
Urologjisë kryhen mbi  
400 operacione për  
gjashtë muaj **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

**DORËHEQJA  
E PAMENDUAR E  
HARADINAJT** **F. 8**



Nga: Alfons GRISHAJ

## AKTUALE



**29 PERSONA MBESIN TË  
VDEKUR NGA DY SULME NË EL  
PASO TË TEKSASIT DHE OHIO** **F. 6**

**HARADINAJ: T'I KRYEJMË  
PUNËT QIND PËR QIND** **F. 6**

**RINIA DEMOKRATIKE KONSTITUON  
SHTABET ZGJEDHORE, BËHET  
GATI PËR ZGJEDHJE** **F. 7**

## EKONOMI

**KËRKOHEM STRATEGJI  
ZHVILLIMORE PËR 183 802  
BIZNESE NË KOSOVË** **F. 9**

## SPORT



**TRANSFERIME ME 'BOLLËK'  
NË SUPERLIGË** **F. 13**

**SUPERKUPA I TAKON CITYT**

**F. 13**

FLET PËR "EPOKËN E RE", NASER RUGOVA **FAQE 4-5**



## LDK-ja do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme

- Isa Mustafa, Lutfi Haziri, Vjosa  
Osmani dhe Kujtim Shala janë  
kandidatë seriozë për kryeministër

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka bërë me dije se kjo parti do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Ai ka thënë se tri partitë më të mëdha në vend - LDK, PDK dhe LV - do të duhej të garojnë të

vetme për ta rikonfirmuar fuqinë në elektorat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka deklaruar se LDK-ja do ta ketë një kandidat konsensual për kryeministër. Ai ka thënë se, përveç Isa Mustafës, kandidatë seriozë për

kryeministër janë edhe Lutfi Haziri, Vjosa Osmani dhe Kujtim Shala. Ai ka shprehur optimizëm se në zgjedhjet e parakohshme parlamentare LDK-ja do të dalë fituese. Rugova e ka quajtur demokratik procesin e zgjedhjes së Musfatës në krye të LDK-së

## Këtë javë pritet të shpërndalet Kuvendi?

Kryesia e Kuvendit do të mbledhet sot (e hënë) me fillim nga ora 11:00. Subjektet politike parlamentare do të diskutojnë rreth caktimit të datës për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Burime të gazetës "Epoka e re" kanë bërë me dije se këtë javë pritet të mbahet seanca e jashtëzakonshme

për shpërndarjen e legjislaturës së VI. Sipas Kushtetutës së Kosovës, shpërndarja e Kuvendit ndodh me dy të tretat e votave (2/3). Ndërkaq jo më herët se tridhjetë ditë dhe më vonë se dyzetepesë ditë pas shpërndarjes së Kuvendit duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme **FAQE 3**



**Specialja vazhdon intervistimet,  
veteranët kërkojnë  
përsëri shfuqizimin e saj** **FAQE 7**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Ligji i ri në vjeshtë, bashkive u hiqet administrimi i bregdetit

TIRANË, 4 GUSHT (ER) - Administrimi i vijës bregdetare nuk do të bëhet më nga bashkitë, por nga shteti. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka njoftuar se në shtator do të kalojë ligji i ri në Kuvend, që ua heq bashkive administrimin e bregdetit. "Pushtimi i plazheve publike dhe rrumpalla në administrimin e plazheve e të terri-

torit bregdetar në tërësi nga njësitë vendore duhet të marrë fund. Beteja e Policisë së Shtetit dhe inspektorateve qendrore, qysh nga fillimi i korrikut, po ndikon në përmirësimin situatës, por nuk mjafton. Në vjeshtë në Kuvend do të ndodhë ligji i ri për mbrojtjen dhe administrimin e vijës bregdetare nga shteti. Kjo pasuri kombëtare i takon popullit dhe pushimet u takojnë njerëzve, jo abuzuesve të çdo

kategorie; nga tregtarët që nuk lëshojnë kupon, tek harbutët që zaptojnë plazhet dhe deri tek zyrtarë shtetërorë e pushtetarë vendorë, të cilët, në vend të detyrës ndaj vendit dhe pushuesve, u bëjnë qoka dëmtuesve e zhurmuesve. Zero tolerancë ndaj abuzuesve nuk është moto fushate, po linja e re e qeverisjes. Deri në fund dhe në çdo drejtim", ka shkruar Rama.



# 29 persona mbesin të vdekur nga dy sulme në El Paso të Teksasit dhe Ohio

EL PASO, 4 GUSHT (ER) - Një person i armatosur me pushkë ka hapur zjarr në dyqanin e njohur "Walmart" në El Paso të Teksasit të shtunën dhe ka lënë të vrarë 20 persona dhe plagosur 26 tjerë deri kur u dorëzua para policisë. Shumë qytetarë ishin duke bërë blerje kur u përballën me sulmin vetëm 6 ditë pas sulmit të një adoleshenti ndaj tre personave në Kaliforninë veriore.

Sulmuesi i Teksasit është identifikuar nga autoritetet si një 21-vjeçar, ndërsa mediat kanë raportuar se ai quhet Patrick Crusius.

Shefi i Policisë në El Paso, Greg Allen, ka pohuar se autoritetet janë duke hetuar një manifest nga sulmuesi ku dyshohet për krim nga urretja.

Një dokument katër faqe i postuar në një grup që përdoret nga ekstremistët, besohet se është shkruar nga i dyshuari, me mbishkrimin "Sulmi në Walmart", një përgjigje ndaj pushtimit spanjoll të Teksasit. Sulmuesi ka shprehur mbështetje edhe për sulmuesin që la të vrarë 51 persona në dy xhami të Zelandës së Re në mars të këtij viti.

Qyteti El Paso, me rreth 680 mijë banorë në Teksasin Perëndimor, është në kufi me qytetin meksikan Juárez. Po ashtu, edhe nëntë persona kanë mbetur të vrarë në Ohio të Shteteve të Bashkuara në më pak se 24 orë nga sulmi i parë në Teksas ku mbetën të vrarë 20 persona.

Autoritetet thanë se sulmi ka filluar rreth orës 1:22 të mëngjesit të së dielës si dhe 16 persona të tjerë janë dërguar për trajtim pas plagëve të marra. Identiteti i sulmuesit nuk është bërë me dije. Rajoni i Oregonit ku ka ndodhur sulmi është vendi më i njohur për restorant, kafiteri dhe teatër. Byroja Federale e Hetimeve ka deklaruar se është duke bashkëpunuar në hetime.

Sulmi në Ohio erdhi disa orë pas sulmit në El Paso të Teksasit, ku një person 21-vjeçar me pushkë la të vdekur 20 persona dhe dhjetëra të plagosur.

### Sulmet në El Paso të Teksasit dhe Ohio, Kosova solidarizohet me ShBA-në

Për këto sulme në ShBA kanë reaguar edhe udhëheqësit e institucioneve të Kosovës. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka shprehur keqardhje për dy sulmet në Teksas dhe Ohio të Shteteve të Bashkuara ku mbetën të vdekur gjithsej 30 persona. Presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter" ka thënë se është i tronditur nga këto lajme. "I tronditur nga humbja e jetës së njerëzve në El Paso të Shteteve të Bashkuara. Kosova është me zemër dhe mendje me viktimat dhe familjarët e tyre. Më shumë dhimbje për të gjithë pas të shtënave në Ohio. Ne jemi të gjithë me viktimat, familjarët e



tyre dhe Shtetet e Bashkuara", ka shkruar Thaçi.

I tronditur prej sulmeve të fundit në ShBA ka qenë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Në profilin e vet në "Facebook", kryeparlamentari Veseli ka shkruar se populli i Kosovës u qëndron pranë miqve amerikanë në këtë situatë të rëndë. "Jam i tronditur prej masakrave të ndodhura në Dejton, Ohio si dhe El Paso, Teksas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Populli i Kosovës u qëndron pranë miqve amerikanë

në këtë situatë të rëndë. Duke dënuar rëndë këto dy sulme makabre, uroj shërimin sa më të shpejtë për të lënduarit dhe shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjarët dhe të afërmit e viktimave. Unë lutem sot bashkë me ta që shpirtat e pafajshëm të njerëzve të tyre të dashur të gjejnë prehje në botën e përtejme", ka shkruar Veseli. Edhe kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, është shprehur i trishtuar me sulmin me armë në qytetin El Paso të

Teksasit, nga i cili kanë vdekur 20 persona dhe dhjetëra të tjerë janë plagosur. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se bashkëndien me familjet e viktimave dhe lutet për shëndetin e të plagosurve. "Të trishtuar me lajmin për vdekjen e 20 personave dhe dhjetëra të tjerëve të plagosur, pas sulmit me armë në qytetin El Paso të Teksasit, ShBA. Në këto momente, bashkëndiejmë me familjet e viktimave dhe lutemi për shëndetin e të plagosurve", ka shkruar Haradinaj.

## Këshilli i Lartë Gjyqësor në Shqipëri emëron dhjetë gjyqtarë të rinj

TIRANË, 4 GUSHT - Këshilli i Lartë Gjyqësor në Shqipëri ka emëruar dhjetë gjyqtarë të rinj. Këta gjyqtarë, sipas KLP-së, do ta plotësojnë situatën emergjente të krijuar në disa gjykata rrethi ku, për shkak të

dorëheqjeve, largimit nga vettingu apo daljes në pension të togave të zeza, janë krijuar pamundësi të formimit të trupave gjyqësore. Në Shkodër është emëruar Afërdita Caco; në Dibër Ardit Kuka; në

Gjirokastrë Suela Dashi; në Korçë Ervin Sulaj; në Kukës Merita Karaj; në Kurbin Olti Skrame; në Lushnjë Lorena Çabej; në Pukë Amarilda Sulaj; në Sarandë Suela Xhani; dhe në Tropojë Enkeleda Dalipi.



# Këtë javë pritet të shpërndahet Kuvendi?

Kryesia e Kuvendit do të mbledhet sot (e hënë) me fillim nga ora 11:00. Subjektet politike parlamentare do të diskutojnë rreth caktimit të datës për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Burime të gazetës "Epoka e re" kanë bërë me dije se këtë javë pritet të mbahet seanca e jashtëzakonshme për shpërndarjen e legjislaturës së VI. Sipas Kushtetutës së Kosovës, shpërndarja e Kuvendit ndodh me dy të tretat e votave (2/3). Ndërkaq, jo më herët se tridhjetë ditë dhe më vonë se dyzetepesë ditë pas shpërndarjes së Kuvendit duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

Prishtinë, 4 gusht - Legjislatura e gjashtë pritet të shpërndahet këtë javë. Kryesia e Kuvendit të Kosovës do të mbledhet sot (e hënë) në orën 11:00. E vetmja pikë e rendit të ditës do të jetë caktimi i datës për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për shpërndarjen e Kuvendit.

Një burim i mirinformuar i gazetës "Epoka e re" brenda Kuvendit të Kosovës ka bërë me dije se kjo seancë pritet të mbahet këtë javë. "Orientimet janë që seanca plenare për shpërndarjen e Kuvendit të mbahet këtë javë, meqenëse të gjitha subjektet politike parlamentare kanë shprehur gatishmëri për këtë çështje. Nuk ka arsye që kjo të zvarritet edhe më tutje", ka thënë ky burim.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, shpërndarja e Kuvendit bëhet nëse për të votojnë 80 deputetë. "Nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të presidentit të Republikës së Kosovës", thuhet në paragrafin e dytë të nenit 82 të kushtetues.

Po ashtu, Kushtetuta dhe ligji për zgjedhje parashohin që zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzetepesë

(45) ditë pas shpërndarjes së Kuvendit.

Procedura e shpërndarjes së Kuvendit nga deputetët ka ardhur pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj dhe pas refuzimit të koalicionit PAN për të propozuar një mandatar tjetër për kryeministër, ashtu siç e parasheh Kushtetuta.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premtën përmes një shkrese zyrtare ka kërkuar nga Kadri Veseli, si i pari i koalicionit PAN, ta propozojë kandidatin e ri për ta mandatuar për formimin e Qeverisë së Kosovës. Ky i fundit e ka njoftuar shefin e shtetit se PAN-i nuk ka mandatar tjetër për kryeministër dhe se zgjedhjet tani janë e vetmja zgjidhje.

Në përgjigjen e tij zyrtare, kryeparlamentari Veseli e ka njoftuar presidentin se për të hënë ka thirrur mbledhjen e kryesisë së Kuvendit për ta shpërndarë Kuvendin. "Si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës kam vendosur që të hënë, më 5 gusht 2019, të thërras një mbledhje të kryesisë së Kuvendit të Kosovës, bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare, në funksion të veprimeve të cilat duhet t'i ndërmarrim në ditët në vazhdim, konkretisht për të diskutuar për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për shpërndarjen e legjislaturës aktuale të Kuvendit të Kosovës", ka vlerësuar

Veseli.

Ai ka treguar se kjo mbledhje ka për qëllim t'i saktësojë në mënyrë zyrtare dhe institucionale qëndrimet e çdo grupi parlamentar në lidhje me situatën e krijuar pas rënies së Qeverisë së Kosovës si dhe konkretizimin e hapave për përcaktimin sa më të shpejtë të datës së zgjedhjeve të parakohshme. "Ndërkohë, si udhëheqës i koalicionit PAN i kam kthyer përgjigje presidentit të Republikës së Kosovës dhe e kam njoftuar se nuk do të ketë mandatar tjetër. Kam

thënë dhe e përsëris: zgjedhjet janë të pashmangshme dhe janë në interes të Republikës së Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës, si gjithmonë, edhe tash, edhe në të ardhmen, i beson fuqishëm legjitimitetit qytetar", është shprehur ai, duke shtuar se Kosova ka nevojë për një qeveri të re pas zgjedhjeve.

Që nga dorëheqja e Haradinajt të gjitha partitë politike kanë shprehur vullnetin e tyre për zgjedhje. Madje ato kanë nisur aktivitetet e tyre përgatitore për zgjedhje të

parakohshme.

Dorëheqja e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës ka krijuar shumë paqartësi jo vetëm politike, por edhe juridike dhe kushtetuese, pasi ka ngritur dilemat nëse ka apo jo aktualisht Kosova qeveri, qoftë edhe me kompetenca të kufizuara. Haradinaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit më 19 korrik, pasi është ftuar nga Prokuroria Speciale me seli në Hagë për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit.

## Hoxha: Zgjedhje të parakohshme për t'i vazhduar proceset integruese

PRISHTINË, 4 GUSHT - Për t'i shmangur ngecjet në proceset integruese që mund të shfaqen nga situata aktuale politike në të cilën ka hyrë Kosova, vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme, thotë ministrja në dorëheqje e Integrimi Evropian, Dhurata Hoxha.

Në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", Hoxha ka theksuar se është e rëndësishme të mos lejohet një vakum institucional pasi janë shumë procese

të rëndësishme integruese të cilat duhet të vazhdojnë. "Në situatën në të cilën gjendemi po e shohim se zgjedhjet janë të pashmangshme, është krijuar një situatë ku qytetari duhet ta thotë fjalën e vet dhe ta legjitimojë qeverinë e re e cila do t'u prijë proceseve në të cilët jemi e që janë shumë të rëndësishme për vendin tonë. Zgjedhjet janë një proces që edhe vendet e tjera kanë kaluar, zgjedhjet e parakohshme ndodhin edhe pse

nuk është dashur, por pa marrë parasysh, jemi në një situatë ku zgjedhjet janë të pashmangshme dhe unë besoj që sa më shpejt të mbahen ato do ta eliminojnë apo kufizojnë zvarritjen e reformave", ka thënë Hoxha. Marrëveshja e Stabilizim Acocimit (MSA), thekson Hoxha, dhe reformat që kërkohen nga kjo marrëveshje, duhet të vazhdojnë të zbatohen, pasi edhe ashtu nuk ka pasur një dinamikë të duhur.



Flet për "Epokën e re", Naser Rugova

# LDK-ja do të garojë e vetme



## - Isa Mustafa, Lutfi Haziri, Vjosa Osmani dhe Kujtim Shala janë kandidatë seriozë për kryeministër

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka bërë me dije se kjo parti do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Ai ka thënë se tri partitë më të mëdha në vend - LDK, PDK dhe LV - do të duhej të garojnë të vetme për ta rikonfirmuar fuqinë në elektorat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka deklaruar se LDK-ja do ta ketë një kandidat konsensual për kryeministër. Ai ka thënë se, përveç Isa Mustafës, kandidatë seriozë për kryeministër janë edhe Lutfi Haziri, Vjosa Osmani dhe Kujtim Shala. Ai ka shprehur optimizëm se në zgjedhjet e parakohshme parlamentar LDK-ja do të dalë fituese. Rugova e ka quajtur demokratik procesin e zgjedhjes së Musfatës në krye të LDK-së

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 GUSHT - Zyrta i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë të dielën se Kuvendi i Nëntë Zgjedhor i kësaj partie ka qenë demokratik dhe janë respektuar të gjitha normat

statutare gjatë zgjedhjes së Isa Mustafës kryetar. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka deklaruar se në zgjedhjet e ardhshme kryetari i partisë duhet të zgjedhet me dy e më shumë kandidatë dhe me votë të fshehur.

Rugova ka thënë se 40 për

qind e Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së janë figura të reja dhe, sipas tij, ndryshime do të ketë edhe në kryesia e partisë që do të zgjedhet gjatë kësaj jave. Deputeti i LDK-së ka bërë me dije se kjo parti do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Sipas Rugovës, LDK-ja do ta ketë një kandidat konsensual për kryeministër. Ai ka thënë se, përveç Isa Mustafës, kandidatë seriozë për kryeministër janë edhe Lutfi Haziri, Vjosa Osmani e Kujtim Shala. Ai ka shprehur optimizëm se në zgjedhjet e parakohshme parlamentare LDK-ja do të dalë fituese.

**"Epoka e re":** Z. Rugova, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Kuvendin e IX Zgjedhor ka rizgjedhur Isa Mustafën edhe për një mandat në krye të partisë. Si e komentoni këtë proces zgjedhor?

**RUGOVA:** Me mbajtjen e Kuvendit të Nëntë Zgjedhor është përmbyllur cikli zgjedhor i LDK-së. Ky kuvend ishte demokratik meqë janë respektuar të gjitha normat statutare sepse statuti i një partie është sikurse kushtetua për shtetin. Kanë qenë dy kandidatë të propozuar, por mbështetjen e 50 plus 1 për qind të delegatëve e ka marrë vetëm

kryetari i rizgjedhur, Isa Mustafa. Ai është zgjedhur kryetar pasi që është i vetmi që e ka kaluar këtë kriter/normën statutare 50 plus 1 për qind të delegatëve të pranishëm.

**"Epoka e re":** Pikërisht kjo normë po ua pamundëson të tjerëve kandidimin dhe për këtë ka pasur shumë kritika.

**RUGOVA:** Statuti është hartuar dhe votuar në konsultim edhe me ekspertët e partive simotra pra, Partive Popullore Evropian. Personalisht mendoj se kjo normë statutare duhet të ndryshohet, por përderisa ky statut është në fuqi, jemi të obliguar ta respektojmë. Sa i përket anës formale-juridike statutare dhe procedurale çdo gjë ka shkuar në rregull, por jam i tharë që në zgjedhjet e ardhshme ta ndryshojmë këtë normë statutare dhe kryetari i partisë të zgjedhet me dy e më shumë kandidatë dhe me votë të fshehur. Mirëpo në aspektin formal dhe juridik është respektuar statuti i LDK-së.

# në zgjedhjet e parakohshme

barrën kryesore që të organizohemi për t'i fituar zgjedhjet. Sondazhet e të gjithë mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë LDK-në e qesin subjektin më të besueshëm të qytetarët e Kosovës.

**"Epoka e re":** LDK-ja kur do ta ketë kryesinë e re dhe a priten ndryshime?

**Rugova:** Pas zgjedhjes së kryetarit dhe Këshillit të Përgjithshëm, pres që këtë javë të zgjedhet edhe kryesia e re e partisë. Pastaj LDK-ja do ta fillojë mobilizimin për zgjedhje parlamentare që do të mbahen në vjeshtën e hershme të këtij viti. Gjithsesi se do të ketë ndryshime në kryesi, pra pritet të ketë figura të reja dhe freskime ashtu siç pati në Këshillin e Përgjithshëm.

**"Epoka e re":** Në këto zgjedhje LDK-ja do ta ketë kandidatë për kryeministër Isa Mustafën apo ndonjë kandidat konsensual?

**Rugova:** Kandidatura e kandidatit për kryeministër do të miratohet në Këshillin e Përgjithshëm të LDK-së. LDK-ja ka mjaft potencial politik, profesional e akademik për ta drejtuar qeverinë e re të Kosovës. Besoj se LDK-ja do ta ketë një kandidat konsensual për kryeministër, dikush që ka mbështetje gjithëpopullore në të gjitha trevat e Kosovës. Kandidati për kryeministër do ta ketë përvojën politike, dijen dhe përgatitjen akademike që vërtet ta bëjë ndryshimin e nevojshëm në krye të qeverisë.

**"Epoka e re":** Është ky Isa Mustafa?

**Rugova:** Isa Mustafa e ka dëshmuar cilësinë e qeverisjes së tij dhe ajo nuk krahasohet me qeverisjen Haradinaj sepse qeveria në largim është qeveria më e dobët që nga paslufta. Por, ka edhe emra të tjerë të cilët dinjitetshëm mund ta udhëheqin qeverinë e vendit.

**"Epoka e re":** Sidomos është përfolur emri i Lutfi Hazirit, madje është thënë se ka qenë një marrëveshje paraprake që Mustafa të zgjedhet kryetar i partisë e Haziri të jetë kandidat për kryeministër.

**Rugova:** Nuk kam informata se ka marrëveshje paraprake për kandidatin për kryeministër, mirëpo z. Haziri është një figurë e rëndësishme e LDK-së i cili në të gjitha garat elektorale ka dalë fitues dhe ai do të mund të ishte një kandidat serioz për kryeministër. Por, LDK-ja ka edhe shumë emra të tjerë që do t'i bëjnë nder edhe vendit, edhe

LDK-së gjatë udhëheqjes së qeverisë. Ka edhe plot emra të tjerë si Vjosa Osmani që është femra më e votuar në Kosovë dhe që i ka të gjitha kredencialet politike, profesionale dhe akademike. Gjithashtu, mund të jetë edhe Kujtim Shala një figurë e respektuar në LDK si dhe dhjetëra të tjerë, pa dashur të përmend në emra të përveçëm të cilët mund të jenë kandidatë seriozë për ta udhëhequr qeverinë.

**"Epoka e re":** Kushdo që të jetë kandidat për kryeministër, cilat janë pritjet nga këto zgjedhje?

**Rugova:** LDK-ja do të jetë partia fituese e zgjedhjeve. Shpresa e vetme e qytetarëve është LDK-ja si partia që i ka të gjitha kredencialet për ta udhëhequr vendin. Jemi të bindur se LDK-ja do t'i fitojë zgjedhjet dhe do ta qeverisë vendin.

**"Epoka e re":** Të gjitha partitë po thonë se do ta dalin të parat.

**Rugova:** Matjet e fundit po tregojnë cila është partia e parë. Në të gjitha sondazhet e fundit LDK-ja është e para. LDK-ja është lokomotiva prijatë dhe proceseve politike në Kosovë.

**"Epoka e re":** LDK-ja në këto zgjedhje do të garojë e vetme apo do të ketë koalicionë parazgjedhore?

**Rugova:** Është mendim i artikuluar në lidhje me strukturën dhe anëtarësi, që LDK-ja të shkojë e vetme në këto zgjedhje sepse lista e LDK-së do t'i ketë të gjitha potencialet që i nevojiten vendit. Besoj se LDK-ja do të garojë e vetme dhe do të dalë fituese.

**"Epoka e re":** Pavarësisht prej përpjekjeve për një bashkëpunim me Lëvizjen Vetëvendosje, nuk do të ketë mundësi që këto dy parti të shkojnë me një listë në këto zgjedhje?

**Rugova:** Tri partitë më të

mëdha në vend, LDK, PDK dhe LV, do të duhej të garojnë të vetme, pra të maten në popull dhe cila të dalë e para duhet ta qeverisë vendin. Gjithnjë e më shumë është vlerësim dhe mendim i artikuluar që LDK-ja të shkojë e vetme në këto zgjedhje sepse jemi të bindur në fitore.

**"Epoka e re":** Gjendja shëndetësore e kryetarit Mustafa, a do të jetë e metë për partinë gjatë fushatës meqë nevojitet një angazhim më i madh i liderit në elektorat?

**Rugova:** Gjendja shëndetësore e kryetarit Mustafa duket se është stabile dhe konsideroj se ai do ta ndërtojë një ekip dhe zgjedhjet i fiton ekipi. Mbështetja, qasja dhe përvoja e tij do ta ndihmojnë shumë LDK-në në të gjitha aspektet. Pas këtyre zgjedhjeve LDK-ja do të kthehet aty ku e ka vendin, si parti e parë në nivel vendi.

## Në Klinikën e Urologjisë, mbi 400 operacione për gjashtë muaj

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

**PRISHINË, 4 GUSHT** - Në Klinikën e Urologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) janë kryer mbi 400 operacione gjatë pjesës së parë të këtij viti. Drejtori i Klinikës së Urologjisë, Sabit Mehmeti, ka thënë se në dy salla operative kryhen ndërhyrje kirurgjike, duke filluar prej intervenime të vogla e deri tek ato më të ndërlikuara dhe më sfiduese. "Duke marrë parasysh gamën e gjerë të operimeve të kryera me sukses të lartë, nevoja për dërgim të pacientëve jashtë ven-

dit është relativisht e vogël. E gjithë kjo punë arrihet me ndihmën e pamohueshme dhe bashkëpunimin e ngushtë me Klinikën e Anestezilogjisë", ka thënë Mehmeti.


Sipas raportit gjashtëmuajor të punës, urologët kanë trajtuar me ESËL (aparaturë për thyerjen e gurëve në veshkë dhe ureter) 330 pacientë.

Brenda kësaj kohe janë bërë më shumë se 600 ekzaminime endoskopike, 50 ekzaminime urodinamike, 30 aplikime të nefrostomave dhe 100 biopsi të prostatës.

Mehmeti, më tutje, thotë se

hapja e qendrës së re ambulatore ua ka dhënë mundësinë mjekëve të pranojnë numër më të madh të pacientëve. "Me këto kushte të ofruara janë shumë të kënaqur si pacientët, të cilët përgëzojnë dhe falënderojnë çdo ditë për shërbimet e ofruara, po ashtu edhe personeli mjekësor", ka pohuar drejtori i Klinikës së Urologjisë.

Mjekët specialistë i janë përgjigjur kërkesës së 3 523 pacientëve për kontrollë mjekësore në ambulancat specialiste, 500 raste më shumë në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit të kaluar.



**"Epoka e re":** Pavarësisht prej pritjeve, edhe në këto zgjedhje nuk pati ndryshime në LDK. Rizgjedhja e Mustafës në krye të partisë është përcjell me skepticizëm nga disa zyrtarë të LDK-së, por edhe nga analistët. Në fakt, mund të sjellë LDK-ja ndryshime në Kosovë e cila nuk po mund ta ndryshojë vetveten?

**Rugova:** Kryetarin e partisë nuk e zgjedh opinioni, mediet, analistët e as rrjetet sociale, por e zgjedhin delegatët. Delegatët e Kuvendit të IX Zgjedhor të LDK-së e kanë zgjedhur të shtunën Isa Mustafën kryetar. Sa iu takon ndryshimeve në Këshillin e Përgjithshëm, rreth 40 për qind janë njerëz që nuk kanë qenë më herët, janë kryetarët e degëve, kryetarët e komunave, deputetë dhe ky ndryshim i Këshillit të Përgjithshëm besoj se do të reflektojë edhe në përbërjen e re të kryesisë së partisë. Presim që këto ditë të shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare dhe kryesia do ta ketë

## Haradinaj: T'i kryejmë punët qind për qind



"Është në interesin tonë që ta përfundojmë Kosovën si shtet qind për qind, t'i kryejmë punët qind për qind, të bashkojmë shtetin tonë me kombin kudo që janë shqiptarët dhe t'i bashkohemi familjes euroatlantike sepse aty është vendi ynë, aty janë vlerat tona, aty është nderi ynë", ka thënë të dielën kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, në tubimin përkujtimor kushtuar 21-vjetorit të betejës së Markalleshëve

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

**GIJAKOVË, 4 GUSHT** - Kryeministri në dorëheqje i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të dielën në tubimin përkujtimor kushtuar 21-vjetorit të betejës së Markalleshëve dhe dëshmorëve Mark Lleshi, Prend

Lleshi, Kolë Lleshi dhe Memë Lleshi. Fillimisht kryeministri Haradinaj bëri homazhe te memoriali i dëshmorëve Mark, Prend, Kolë dhe Memë Lleshi. Para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj ka thënë se po ndihet jashtëzakonisht mirë që sot ka pasur nderin të kalojë pak çaste te Markalleshët, familje kjo që ka një histori të veten të gjatë, edhe në luftëra të tjera, kohë të tjera sikurse edhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore, ku nga kjo familje ranë dëshmorë njerëz të shquar. "U pushkatuan padrejtësisht. Andaj më lejoni sot t'ju falënderoj të gjithëve për praninë në nderim të betejës së Markalleshëve të 7 gushtit, por edhe të heronjve të Kosovës të rënë edhe më vonë. Dua të them disa fjalë për ditën e sotme pse është me rëndësi kujtesa jonë për të kaluar nëpër momente të vështira sepse janë bërë 20 vjet nga kjo betejë, por edhe është kaluar një kohë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se më së miri ndoshta kjo shpjegohet me faktin se nuk dihet që ka lindje më të vështirë sesa lindja e shtetit. "Një lindje e këtillë kaq e vështirë është jashtëzakonisht e veçantë dhe ne jemi nisur që t'i takojmë familjes së shteteve sepse jemi bërë shtet, e kemi shpallur veten shtet dhe duam të

jemi në tavolinën e shteteve që janë si Amerika dhe të tjerët veç e veç", është shprehur Haradinaj. Ndër të tjera, Haradinaj ka shtuar se e dimë se për këtë Kosovë ka pasur shumë flijime, përndjekje, masakra e gjenocid, tmerre që i ka përjetuar populli ynë për të ardhur deri te dita e qershorit e '99-s. Në këtë familje të Markalleshëve, sipas kryeministrit Haradinaj, ndër breza ruhet kjo sakrificë dhe e dinë se si ka qenë rruga jonë deri këtu. "Është në interesin tonë që ta përfundojmë Kosovën si shtet qind për qind, t'i kryejmë punët qind për qind, ta bashkojmë shtetin tonë me kombin kudo që janë shqiptarët dhe t'i bashkohemi familjes euroatlantike sepse aty është vendi ynë, aty janë vlerat tona, aty është nderi ynë. Nëse shërbehemi me shembullin e kësaj familjeje rruga jonë do të jetë e lehtë, pa asnjë dilemë dhe do të arrijmë së bashku dhe uroj që në këtë shembull, në këtë sakrificë të Markalleshëve, të të gjithë dëshmorëve, të shërbehemi si komb", ka thënë Haradinaj. Nga një fjalë para të pranishmëve mbajtën Dervish Tahiri nga Kuvendi Komunal i Gjakovës, Don Alberti, famullitar, ndërsa në emër të familjes foli Gegë Lleshi.

## Mustafa: Në Kuvendin Zgjedhor të LDK-së u demonstrua kulturë demokratike

**PRISHTINË, 4 GUSHT (ER)** - Pas rizgjedhjes kryetar i LDK-së, Isa Mustafa ka falënderuar delegatët e Kuvendit të Nëntë Zgjedhor të partisë për besimin e dhënë. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në Kuvendin e Nëntë Zgjedhor të LDK-së u demonstrua një kulturë demokratike. "Në Kuvend u demonstrua një kulturë demokratike, e muratur me durim dhe përpjekje të mëdha gjatë 30 vjetëve të zhvillimit dhe ekzistencës dhe veprimit të LDK-së. E trashëguar dhe e kultivuar me kujdes dhe respekt nga kryetari dhe presidenti ynë historik, Ibrahim Rugova. Kjo është vlerë e jonë e përbashkët.

Kuvendi ynë unifikoi diversitetin tonë të mendimit dhe të veprimit, që emërues të përbashkët e ka programin tonë politik të qendrës së djathtë dhe, për më shumë, e ka Kosovën tonë. Kuvendi na bashkoi të gjithëve. Të gjitha gjeneratat dhe të gjitha aspiratat. Kështu, bashkë, do të shkojmë drejt fitores së madhe në zgjedhjet e ardhshme. Kur jemi bashkë, s'ka kush që na del para. E konsideroj veten të nderuar me besimin që ma dhanë delegatët e Kuvendit. Këtë besim e meritojnë dhe e kanë merituar shumë veprimtarë dhe veprimtare të LDK-së", ka thënë lideri i LDK-së, Isa Mustafa.



## UPZ-ja arrin bashkëpunim me universitetin Camarino në Itali



**PRIZREN, 4 GUSHT (ER)** - Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj dhe prorektorët, prof. ass. dr. Shems Morina, kanë pritur në takim një delegacion nga Universiteti i Camarinos në Itali, me ç'rast është iniciuar bashkëpunimi dypalësh. Bashkëpunimin ndërmjet dy universiteteve e kanë iniciuar

zëvendësministri i Diasporës, Afrim Bektashi dhe Ariana Kosova, presidente e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Itali, e cila ishte pjese e takimit. Rektori Temaj e ka vlerësuar lart fillimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, duke theksuar se do të kujdesen që kjo iniciativë të jetë frutdhënëse.

Zëvendësministri i Diasporës, Afrim Bektashi, ka thënë se për të ka qenë nder, privilegj dhe emocion i veçantë që të kujdeset për këtë takim pasi ka qenë më herët edhe vetë student i UPZ-së. Ai ka shtuar se ashtu si ka ndodhur me UP-në do të kujdeset që edhe studentët e UPZ-së të fitojnë bursa për të studiuar në universitetin Camarino.

# Specialja vazhdon intervistimet, veteranët kërkojnë përsëri shfuqizimin e saj

Prishtinë, 4 gusht - Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Time Kadrijaj, është ish-pjesëtarja e fundit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ka pranuar ftesë për t'u intervistuar nga Gjykata Speciale. Ndonëse ende nuk e di cilësinë në të cilën është ftuar të dëshmojë, deputetja Kadrijaj thotë se nuk ka vendosur nëse do të qëndrojë në heshtje apo do të përgjigjet në pyetjet e Prokurorit të Specializuar. "Do të kontaktoj me ndonjë prej avokatëve tanë dhe varësisht prej rekomandimeve që do të marrë prej avokatit do të veproj. Unë jam e lumtur për atë periudhë kohore të jetës sime. Është periudha më e ndritshme dhe vazhdoj të jem krenare me UÇK-në dhe luftën e pastër dhe të drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Kadrijaj për "Radion Evropa e Lirë".

Avokati Arianit Koci, i cili është i akredituar për të përfaqësuar raste pranë Gjykatës Speciale, thotë se ky institucion është treguar i ngathët, pasi janë bërë gati tetë vjet prej se fillimisht kishin nisur hetimet.

Koci thotë se Gjykata Speciale është duke menaxhuar në mënyrë të çuditshme edhe procesin e intervistimit të të dyshuarave dhe dëshmitarëve. "Flitet, ka indikacione që është në fazën e fundit hetimi i këtyre ditëve, edhe pse nuk mundet të garantohet asgjë për shkak se tani e kemi një hetim të paza-

kontë që 7-8 vjet të gjatë, kështu që nuk mundet askush saktësisht të parashikoj se kur do të përfundojnë hetimet dhe në çfarë forme do të ngiten aktakuzat eventuale. Sidoqoftë, nëse vazhdon kështu me këtë ngathtësi e ashtuquajtura Gjykata Speciale, unë do të jem i zëshëm që vitin tjetër mandati të mos i vazhdohet. Mbi të gjitha për të njëjtat çështje i ka trajtuar Tribunali i Hagës, Gjykata e UNMIK-ut si gjykatë ndërkombëtare, Gjykata e EULEX-it dhe gjykatat vendore", ka thënë Koci. Në anën tjetër, veteranët e luftës së UÇK-së presin që të ketë numër më të madh të ish-pjesëtareve që do të ftohen nga Specialja.

Kryetari i OVL të UÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se numri i të ftuarve për intervistim nga Prokurori i Specializuar pritet të rritet deri në fund të muajit gusht. "Pritet një numër bukur i madh që këtë muaj të lajmërohen në Gjykatën Speciale. Kjo po dihet se më shumë është politike sesa për zbulimin e ndonjë rasti aty-këtu që flitet. Unë gjithmonë besoj se s'do të gjejnë faje dhe nuk do të ketë argumente për këto aktakuza", ka deklaruar Gucati. Ai është kritik ndaj liderëve politikë të cilët, sipas tij, nuk e kishin seriozisht kur para pak muajsh tentuan ta shfuqizonin Gjykatën Speciale.

Ai ka thënë se veteranët janë optimistë se në rast se do të ketë



zgjedhje të reja, atëherë një përbërje e Kuvendit do ta votojë shfuqizimin e Speciales. "Shpresojmë se në vitin 2020 do të bëhet shfuqizimi i kësaj gjykate, gjithmonë duke shpresuar sepse këta vetë e kanë votuar dhe unë besoj se historia do t'i dënojë këta deputetë të Kuvendit të Kosovës që e kanë votuar këtë Gjykatë Speciale të njëanshme", ka deklaruar Gucati.

Më 19 korrik kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, dha dorëheqje të papritur pasi njoftoi se kishte pranuar ftesë

për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për krime të luftës. Pas përfundimit të intervistimit në Gjykatën Speciale, Haradinaj tha se do të mbrohet në heshtje dhe se nuk është ngritur aktakuzë për të.

Nga Prokurori i Specializuar u intervistua edhe ish-anëtari dhe zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili njoftoi se ishte intervistuar në cilësinë e të dyshuarit. Prej se ka filluar procesin e intervistimit, dhjetëra ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

janë paraqitur për intervistim pranë Gjykatës Speciale me seli në Hagë. Gjykata Speciale u formua pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës, në gusht të 2015-s, votuan për themelimin e saj. Formimit të Gjykatës Speciale i parapriu një rezolutë në Këshillin e Evropës që kërkonte hetime mbi supozimet e senatorit zviceran Dick Marty, i cili pretendonte se pjesëtarë të UÇK-së kanë kryer krime lufte dhe kanë trafikuar organe të serbëve të vvarë gjatë luftës në Kosovë.

## Rinia Demokratike konstituon shtabet zgjedhore, bëhet gati për zgjedhje



**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 4 GUSHT - Rinia Demokratike e Kosovës është duke zhvilluar aktivitete të pandërprera, duke bërë mobilizimin e çdo dege të Rinisë Demokratike për procesin e

ardhshëm zgjedhor, duke zgjedhur shtabet e tyre zgjedhore dhe është e gatshme për zgjedhje. Këtë e ka konfirmuar kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës, Donjet Bislimi, i cili ka potencuar se "tashmë të gjitha degët e rinisë kanë zgjedhur shtabet e tyre zgjedhore dhe janë të gat-

shëm për zgjedhje", i cili njëherësh shpreh edhe vullnetin e kësaj organizate rinore për të kontribuar në këtë proces tejet të rëndësishëm për vendin. "Zgjedhjet nacionale janë rast të rikonfirmohet vizioni dhe platforma jonë, Dekada e Re, e cila do të jetë gjithëpërfshirëse, me

vizion për të rinjtë e vendit tonë, për perspektivën tonë këtu dhe për Kosovën brenda vlerave integruese euroatlantike", ka thënë Bislimi. Ai ka shtuar se konstituiimi i shtabeve zgjedhore të Rinisë Demokratike në tërë vendin përbën hapin e nevojshëm për situatën në të cilën ndodhemi. "Këtij

procesi, Rinia Demokratike, si çdoherë, do t'i japë energji, potencial dhe optimizëm mobilizimit të jashtëzakonshëm, ashtu si deri më sot, për ta çuar përpara misionin dhe vizionin e Partisë Demokratike të Kosovës dhe kryetarit Kadri Veseli", është shprehur Bislimi.

# Dorëheqja e pamenduar e Haradinajt



Nga: Alfons GRISHAJ

Mediat dhe opinioni kombëtar dhe ai ndërkombëtar u njohën me dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj. Pothuajse në mënyrë unanime ai u përshëndet nga mediat shqiptare, prononcimet në "Facebook", portalet private etj... duke u quajtur "një hero", një njeri me përgjegjësi dhe vetëdije të lartë, i cili sa herë ka "nevojë" Haga për hulumtime dhe pyetje ekstra... ai jep dorëheqje. Pikërisht këtu nis dhe zanafilla e kritikës sime...

Oh what times! Oh what customs! (Ciceroni)  
Ramush Haradinaj, një luftëtar i thekur lirie, nuk duhet të binte në grackat e antishqiptarëve dhe "eminencave gri" që falen në Serbi. Tashmë ai e kishte përvojën dhe nuhatjen e politikantit të rritur në aksione dhe diplomaci. Populli i Dardanisë dhe Kuvendi i saj i dha dhe një mandat tjetër për t'i shërbyer atdheut në mënyrë të zgjuar e rigorozë, për ta nxjerrë nga kolapsi, korrup-

sionin dhe pazaret e ndyra të ish-bashkëpunëtorëve të tij, të cilët bënin... dhe bëjnë akoma rolin e protagonistëve paqësorë dhe politikanëve profesionistë por që, në fakt, nuk janë asgjë tjetër veç ca servilë, dallkaukë dhe puthadorë të kabanave të vjetra antikombëtare. Haradinaj me veprimin e vet dhe, mbase, edhe këshillat e këqija, i bëri një dëm të konsiderueshëm popullit të vet duke hapur portat e kështjellës për kalin trojan.

Lidhur me akuzën, Haradinaj ia dha mundësinë disa herë Gjykatës së Hagës (për të cilën ruaj respekt por që, çuditërisht, ky Tribunal që guxon ta thërrasë Haradinaj disa herë, nuk guxon të arrestojë një ushtar të vetëm amerikan që është i akuzuar si Haradinaj!), dhe "gjuetarëve të shtrigave" për të bërë hulumtimet e nevojshme të specializuara. Gjithashtu, ua dha edhe privilegjin armiqve të tij për fabrikimin e akuzave false. Dhe pse Karla Del Ponte do ta përkufizonte si kriminel lufte dhe trysnia e mekanizmit dinak të qarqeve jomiqësore ishte e madhe, ai mori pafajësinë. Vuçiqi do ta quante lëvizjen e fundit (dorëheqjen) të Haradinajt: "Mashtrim politik!" Por prapa kuintave nuk ndajnë të njëjtin mendim

udhëheqësit e qeverive evropiane, të cilët e kanë përshëndetur për sy e faqe qëndrimin e Haradinajt por që, në fakt, janë dashnorët e Vuçiqit.

Duke e njohur këtë realitet të trishtuar alternativ e subjektiv, armiku e quan "Mashtrim politik", kurse "miqtë" që bëjnë orgji me armikun e brohorasin?! Ky është kulmi i prostitucionit politik. Litari në dy skajet e humnerës ka qenë gjithnjë ura jonë për të kaluar në Evropë. Flip-flapet e politikanëve evropianë i kanë kushtuar shtrenjtë Shqipërisë. Nëse këta politikanë e quajnë vendimin e Hagës të padrejtë, përse nuk dalin hapur në mbrojtje të Haradinajt? Dihet botërisht dhe nga kalamajtë se për një akuzë që merr pafajësinë dy herë nuk mund të bëhen më hulumtime të tjera, sepse tregohet mungesë profesionalizmi dhe serioziteti. Në prag të kësaj thyerje, Gjykata e Hagës do ta merrte emrin Mejhana e Krrabës. Kjo mungesë serioziteti e institucionit të Hagës duhet ta sillte, si pasojë, injorimin total të riakuzës nga Haradinaj, por ai nuk e bëri! Mendoj se koha e eksperimenteve dhe heroizmave ka mbaruar. Mekanizmi i zhvillimit të një shteti nuk është si mulliri, që mund ta ndalësh sa herë që bluhet mielli. Po e

ndale mekanizmin e shtetit, pushon zhvillimi, ndalet ora dhe mbretëron kaosi. Ky burrë duhet ta dijë mirë këtë. Nuk bëhen eksperimente në një laborator pa lëndën kryesore dhe epruveta. Çdo eksperiment i tillë sjell dështim të shkallëzuar. Si mund ta lësh vendin tënd në amulli për t'i plotësuar kapriçot e të huajve? Ç'është kjo mendjelehtësi?! Sepse kështu i bie që sa herë t'i teket b... matrapazëve të huaj, ne duhet t'i ulim pantallonat dhe t'i themi: hajdeni o burra se këtu na keni!

Detyra ndaj atdheut është gjëja më e shenjtë që për asnjë moment nuk duhet të përzihet me pasionin dhe reaksionin personal, partiak dhe pazaret e të huajve, sepse atëherë dalim të gabuar, për të mos thënë tradhetojmë vetveten dhe kauzën e shenjtë ndaj atdheut. Përgjegjësia ndaj kombit dhe popullit tënd nuk është uni naiv, por thelbi i shtyllës imperative që buron nga ndërgjegjja dhe përgjegjësia kombëtare që në asnjë rrethanë apo moment nuk mund të tjetërsohet në aksiomë politike personale. Këtë duhet ta dijë çdo njeri që hyn në politikë dhe që kërkon ta udhëheqë popullin e vet drejt lirisë dhe prosperitetit. Haradinaj gaboi. Gabimi i tij

duhet t'i vlejë çdo shqiptari si mësim... që përpara se t'i shërbejë drejtësisë së shitur dhe urisë së verbër ndërkombëtare duhet t'i shërbejë me devocion dhe besnikëri detyrës së dhënë nga populli, pastaj ta ushqejë oreksin e portave të dallaveraxhinjve që në shekuj na nënçmuan, bile na quajtën dhe "Njerëz me bisht"!

Sikur ne te ishim me të vërtetë pjesë e Evropës dhe ajo të na donte aq fort... do të na pranonte kështu siç jemi. Atëherë do të ishim të detyruar të kryenim çdo obligim ligjor dhe moral. Po Evropa kërkon të na imponojë standarde që, fatkeqësisht, edhe ajo vetë nuk i disponon realisht.

Vëzhguesit "inteligjentë" ksenomanë mund dhe të më vërsulën: "Hej lumë miku, kohët kanë ndryshuar!". Unë u them atyre që koha është e njëjtë! Diplomacia vazhdon pikë për pikë skenarët e vjetër... dhe oreksi i qarqeve antishqiptare ka mbetur po i njëjti. Ka ndryshuar vetëm një realitet që e injorojmë ne vetë të parët: shqiptarët janë më të fortë, janë bërë mal! Një fjalë e urtë japoneze thotë: "Mali nuk lëviz!" Pas kësaj thënie të urtë japoneze i bie që, kush të jetë i interesuar për malin, mirë se të vijë tek mali, në të kundërtën... nuk flitet më për të tillë.

## Përfundon me sukses cikli i dëgjimeve buxhetore në Runik

SKENDERAJ, 4 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se ka përfunduar me sukses ciklin e dëgjimeve buxhetore me Runikun, ku në të gjitha fshatrat që bëjnë pjesë në këtë bashkësi lokale, mbi 20 kilometra rrugë e segmente do të nisin sivjet të asfaltohen, sikurse trotuari e projekte të kanalizimit, sistemit të ujësjellësit dhe projekte të tjera. "Edhe lagjet e fshatrave përreth Çubrelit do të përfitojnë rrugë të reja, që disa prej tyre tashmë kanë filluar, për të vazhduar me projekte në fusha të tjera ku preket interesi qytetar. Dëgjimi i fundit për sivjet është mbajtur në qytetin tonë, me pjesëmarrje të qytetarëve para të cilëve kemi bërë të ditur gjithashtu se punët e mëdha që janë duke u realizuar në kuadër të projekteve të reja, si rezultat i kërkesave të qytetarëve vitin e kaluar, për ta kompletuar infrastrukturën rrugore, ndërtimin e sistemeve të ujësjellësit, të trajtimit të ujërave të zeza,



ndërtimin e shkollave e sallave të sportit, ndërkohë që po vijojnë pa pushim punimet e projekteve të nisura vitin e kaluar", ka thënë kryetari Jashari. Ai ka shtuar se përmbyllja e ciklit të dëgjimeve

për këtë vit shënon hapat e parë të hartimit të një buxheti gjithëpërfshirës për vitin e ardhshëm. "Dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët e komunës sonë për kontributin e dhënë me anë

të kërkesave konkrete, nënkryetarin Nuredin Lushtaku, deputetin Bekim Haxhiu, që na shoqëroi vazhdimisht, të gjithë drejtorët dhe stafin tim mbështetës, që përgjatë gjithë

kësaj jave, dhe krejt pas orarit të punës, kanë bërë një punë të jashtëzakonshme. Tani është radha e konkretizimit në vepër të kërkesave të qytetarëve", ka thënë Jashari.



# Kërkohet strategji zhvillimore për 183 802 biznese në Kosovë

Aktualisht në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) janë të regjistruara 183 802 biznese, prej tyre 5 353 janë biznese të huaja. Përfaqësuesit e bizneseve kanë kërkuar që të përpilohet një strategji zhvillimore ekonomike nga përfaqësues të asociacioneve ekonomike dhe ajo t'i dorëzohet qeverisë. Po ashtu, është kërkuar që të ketë edhe unifikim të afarizmit karshi politikave qeveritare

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 GUSHT - Në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) janë të regjistruara 183 802 biznese, prej tyre 5 353 janë biznese të huaja. Këtë e ka konfirmuar për gazetën "Epoka e re" Zyra për Informim e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Për operimin e mirëfilltë ekonomik të këtyre bizneseve po kërkohet të përgatitet një strategji zhvillimore ekonomike, pastaj t'i dërgohet qeverisë së ardhshme. Po ashtu, është kërkuar edhe unifikim i odave afariste karshi politikave qeveritare. Njohësi i çështjeve biznesore, Lulzim Sylja, ka thënë se është esencial unifikimi i odave të afarizmit në Kosovë në sajë të një strategjie zhvillimore ekonomike. "Është esencial

qëndrimi i odave dhe përfaqësuesve të afarizmit. Vendi ynë është i vogël dhe dihet se cilat biznese i udhëheqin odat, përkundër ndasive që mund të ketë aty-këtu te ndonjë biznes i cili nuk do për t'ia prishur rahatimin vetes shkaku i raporteve me qeverinë. 99 për qind e bizneseve të tjera janë biznese që kanë nevojë për rritje, zhvillim dhe eksport. Mospërfillja e këtyre kërkesave shpie në zhvillim jo të duhur dhe ulje të investimeve masive siç ka ndodhur deri më tani. Është koha e fundit për një mobilizim serioz dhe profesional nëpër asociacione apo oda ekonomike, por edhe nëpër grupime të tjera, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe konceptit për zhvillim ekonomik", ka thënë Sylja, duke shtuar se pos segmenteve makroekonomike, duhet dëgjuar edhe zëri i bizne-

sit. "Pavarësisht prej segmenteve makroekonomike, siç është puna e buxhetit dhe financave apo projektet që janë të natyrës ndërkombëtare, nuk do të thotë se ne duhet të përzihemi aty, por nuk bëjnë keq ta marrin mendimin tonë edhe për çështje të emetimit të bonove të thesarit dhe çështjeve strategjike. Ne nuk kemi nevojë ta presim formimin e qeverisë pasi bizneset vazhdojnë punën dhe kurdo që kanë mundësi bizneset, qoftë Oda Ekonomike dhe ajo Amerikane, duhet të mbledhen me anëtarët e tyre dhe të diskutohet se çfarë është e nevojshme dhe të vihet deri te një dokument përmbajtësor, i cili do të duhet të dalë në debat dhe pastaj më së largu në tetor do të duhet t'i dorëzohet qeverisë", ka thënë ai.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se OEK-u është në diskutim me partnerët për identifikimin e çështjeve kyçe që pastaj do t'i dorëzohen qeverisë. "Fokusi ynë është te ekonomia joformale, tregu i punës, shkathhtësitë e fuqisë punëtore, rritja e eksportit dhe tërheqja e investimeve të huaja direkte", ka thënë Rukqi.

Skender Krasniqi nga Oda e Afarizmit ka bërë me dije se i kanë dorëzuar qeverisjes së kaluar strategji zhvillimore por që, sipas tij, ato strategji nuk

janë përfillur. "Ne nga fillimi i kemi përcaktuar vijat në të cilat do të duhet të shkonte Qeveria e Kosovës për zhvillimin ekonomik afatgjatë. Strategjinë apo ide ia kemi dorëzuar Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe çdo institucioni gjegjës. Duke filluar nga kryeministri, kryetari i Kuvendit dhe ministrat. Fatkeqësisht, Kosova nuk ka strategji reale për zhvillim ekonomik. Deri më tani asnjë qeveri nuk ka treguar strategji reale në këtë aspekt. "Urojmë që në zgjedhjet e ardhshme të kemi një qeveri që përfundimisht do të mendojë për zhvillimin ekonomik. Qeveritë e kaluara kanë folur për ekonomi, por veprat e tyre karshi veprimeve janë të vogla", ka thënë Krasniqi për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa pronari i kompanisë "Meka", Burim Piraj, ka thënë është e çuditshme se për dy dekada nuk është arritur të përfillet zëri biznesor, duke filluar nga problemet me energji, papunësia dhe migrimi. "Në vazhdimësi odat e afarizmit i kanë parashtruar problemet me të cilat ballafaqohet biznesi me vite por, për çudi, të njëjtat probleme janë bartur nga një qeveri te tjetra për të arritur në atë pikë që Kosova të jetë destinacioni i fundit për investitorët. Paramendojeni kur tërë këto qeveri për dy dekada nuk kanë arritur ta zgjidhin problemin e

furnizimit me energji elektrike. Pa marrë parasysh se çka do të parashtronin odat e afarizmit, mendoj se institucionet tona nuk do të përgjigjen pasi që në praktikë është vërtetuar një gjë e tillë. Thjesht, unë dyshoj në kapacitet e institucioneve për t'u marrë seriozisht me problemet thelbësore dhe për t'u marrë me zhvillimin real ekonomik të vendit", ka thënë Piraj për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, bazuar në problemet prej dy dekadash, ekziston dyshimi se institucionet e vendit janë të penguar nga shërbimet serbe. "Ka dyshime se institucionet tona janë duke u penguar nga shërbimi sekret serb, se ndryshe nuk ka logjikë të jenë kaq të pavëmendshme ndaj këtyre kërkesave që me mosplotësimin e tyre arriti shkalla e papunësisë në nivelin e tillë, sa që njerëzit dhe rinia migrojnë për ta siguruar ekzistencën. Shkalla e migrimit është shumë shqetësuese, ndërsa institucionet tona në mënyrë të qetë e vazhdojnë ahengun", ka thënë ai.

Duke folur për ndikimin që mund ta kishte një strategji e përbashkët, Piraj ka thënë se ndikimi që ka qenë për 20 vjet këtu do të vazhdojë të jetë prapë derisa nuk ndryshohet qasja e përfaqësuesve të institucioneve të vendit karshi çështjes së ekonomisë, zhvillimit të këtij sektori.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (10)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin  
NOVOSELLA**

Baca, Adem Demaçi, Ne, si nxënës tuaj, do të thotë edhe personalisht, unë nxënës i juaj, u frymëzuam nga vepra dhe puna juaj, në rrugën e lirisë për çlirim të Kosovës dhe të viseve të pushtuara nga Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, menduam dhe vazhduam rrugën tuaj gjer në formimin e UÇK-së dhe luftën çlirimtare!

Unë si veteran i UÇK-së të krahasoj me Skënderbeun e Ismail Qemalin! Ju keni bartur stafetën e të gjithë heronjve shqiptarë, të të gjitha kohërave për çlirim e bashkim kombëtar! Prandaj, veteranët e UÇK-së të shpallim HERO të KOMBIT!

Lavdi, Baca Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
Sadik Makolli, veteran i UÇK-së

Ndihem krenar që i takoi të njëjtit komb, të cilit i takoi Baca Adem Demaçi! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Haxhi Dakaj

Nderim për Bacën Adem Demaçin, Shqiptarin e Parë, Njeriun që ishte Abetare për të gjithë shqiptarët tjerë, yll ndriçues i rezistencës sonë! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Kamer Elezaj

Ishim me fat që jetuam në kohën tënde o i pavdekshmi, baca Adem Demaçi! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Ridvan Pakashtica

Lavdi, Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
Lutfi Dauti

Lavdi dhe shumë respekt për Nderin e Kombit, Bacën Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
Zylfi Dauti, Sollothurn, Zvicër

I lehtë të qoftë dhe i Kosovës, Baca Adem Demaçi!. Do jesh me ne gjithmonë! Vepra jote do të jetojë përherë! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Zijadin Dauti

Faleminderit Baca Adem Demaçi! Ti je i gjallë në zemrat e çdo shqiptari!

27 korrik 2018,  
Ermira Zhuri

Prof. Adem Demaçi do mbetet i përjetshëm në zemrat e gjithë popullit shqiptar! Iu kujton përherë shoku juaj i idealit!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm) Kelmendi

Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës o Bacë! Rroftë Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Vepra Juaj do jetojë përherë me ne! Vepra Juaj na obligon ta vazhdojmë aty ku e le Ti! Lavdi baca Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem Demaçi është heroi i popullit të Kosovës! Lavdi!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës që aq shumë e deshe! Kurrkujt nuk i takon ky urim më shumë se Ty! Qoftë i pavdekshëm ndër shekuj emri Yt!

27 korrik 2018,  
Bislim Bajraktari, ish i burgosur

O i madhi i Kosovës, çlirimtari i Kosovës! Lavdi Bacë!

27 korrik 2018,  
Bektesh Rrudhani, ish i burgosur

Njeriut që tërë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare, simbolit të rezistencës kombëtare, ideatorit të UÇK-së! Lavdi për jetë e mot jetës dhe veprës heroike të Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
Kamer Rraci

Faleminderit Baca Adem, që aq shumë dhe aq gjatë ke vuajtur për të gjithë ne dhe për mua gjithashtu... të jam mirënjohës gjithë jetën! Me veprime inteligjente dhe pa asnjë fije dyshimi dhe me zemër trimi ti ishe për të gjithë njerëzit e këtyre trojeve vetë frymëzimi... sa vetëmohues që ke qenë... i madhi ynë Adem Demaçi! Me respekt të përjetshëm!

27 korrik 2018,  
Orhani, Linda, Drini, Jon Prapashtica

Unë Drin Ismajli 17-vjeçar iu shprehu ngushëllime dhe respekt të thellë Familjes Demaçi. Lavdi i çoftë Bacës Adem!

27 korrik 2018,  
Drin Ismajli

Baca ishte kolos i madh i gjithë botës lirisdashëse!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Iu shpreh ngushëllimet dhe respektin për gjithë jetën dhe veprën e Bacës Adem Demaçi! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Ramiz Heta

I pavdekshëm mbetesh, i dashuri Adem Demaçi! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Lazim Destani, Tetovë

Ishe dhe do mbetesh IDOLI IM, HEROI IM! Gjithmonë do të mbetesh në zemrën time!

27 korrik 2018,  
Arben Bytyqi, Prizren

Frymëzuesi dhe mësuesi i çdo kohe, shpirti yt u prehtë në paqe. Ndërsa ne rinia e RKS do vazhdojmë veprën tuaj dhe nuk do të harrojmë kurrë!

27 korrik 2018,  
Familja Krasniqi, Prizren

Lamtumirë Heroi i Kombit! Do të na mungosh! Respekt dhe nderime përjetë!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Rruga e mbarë në parajsë HEROI I KOMBIT! Të fala shokëve të idealit! Së shpejti do të shihemi! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Ramadan Demolli, Besianë

Të shkruash për Bacën Adem Demaçi duhet medoemos të kesh bagazh të madh poetik, artistik, kulturë të gjerë e edukim patriotik e atdhetar. Adem Demaçi ishte simbol i qëndresës atdhetare e patriot i madh! Jetën e kaloi duke u vetëfljuar nëpër burgjet më famëkeqe të ish-Jugosllavisë, afër 28 vjet burg të rëndë, vetëm që kombi shqiptar të jetë i lirë! Lavdi!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Jetoi i lirë! Adem Demaçi është Mendela vetë!.. Na ia kemi borxh



të luftojmë tërë jetën për realizimin e idealeve të Tij! Lavdi bacës, Adem Demaçi, simbolit të lirisë dhe të ruajtjes së bërthamës së kombit shqiptar! Ai ishte dhe mbetet Skënderbeu i kohës se sotme!

27 korrik 2018,  
Milazim Rekalju, Besianë

Dajë, njerëzit si Ti nuk vdesin - JO, se vepra jote nuk shuhet kurrë! I lehtë të qoftë dhe i kësaj Kosove, që aq shumë e deshe!

27 korrik 2018,  
Mbesa jote, Nora Elshani

Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës, Babai i Kombit! Ishe dhe do të mbetesh udhërrëfyes i brezave për ne! Krenaria e një kombi është të jemi KOMB! Kishim fat që të patëm! Do jesh me shqiptarët përjetësisht!

27 korrik 2018,  
Shehrije e Hamit - Rukiqi

Do jesh me ne në përjetësi, Baca Adem! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Shefik Thaçi

I përjetshëm kujtimi për Ty, Bacë!

27 korrik 2018,  
Bukurije Gjonbalaj

Një dorë e vogël e vizatuar (Të duam Baca Adem; Marini dhe Bukuri, shkruan brenda vizatimit)!

27 korrik 2018,  
Marini e Bukuria

Përjetësisht me ne, do jetoj vepra juaj! Ishe e mbetesh fanar lirie, Bacë!

27 korrik 2018,  
Senad (mbiemri i palexueshëm)

Historinë shqiptare e bëjnë katër njerëz: Gjergj Kastrioti, Hasan Prishtina, Enver Hoxha dhe arkitekti i bashkimit kombëtar Adem Demaçi!

Lavdi jetës dhe veprës se Bacës Adem!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm) Berisha

Veprimtaria e Bacës Adem ishte frymëzim i brezave. Veprimtaria e Bacës ishte rrugë e vështirë por e drejtë dhe e lavdishme! Lavdi për jetë e mot!

27 korrik 2018,  
Jusuf dhe Elife Berisha, Podujevë

Kushdo që merret me çështjen kombëtare ka parë se Baca Adem i dha vulë të përjetshme. Ju Bacë jeni nder kolosët më të mëdhenj të kombit!

27 korrik 2018,  
Drita Shala

Njerëzit edhe pse ndërrojnë jetë, veprat e mëdha, që lënë pas, nuk vdesin kurrë! Lavdi Baca Adem!

27 korrik 2018,  
B. Muçolli!

Lavdi shqiptari i shqiponjave! Na mësove si ta duam atdheun!

27 korrik 2018,  
Xhelal Neziri

Njeriu që ia fali gjithë jetën popullit shqiptar! Lavdi!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

## Irani thotë se ka konfiskuar një anije ndërkombëtare në Gjirin Persik

TEHERAN, 4 GUSHT - Garda Revolucionare e Iranit ka konfiskuar një cisternë ndërkombëtare të naftës në Gjirin Persik, pas dyshimeve për kontrabandë me naftë në shtetet arabe. Agjencia

shtetërore e lajmeve "Irna" ka raportuar se cisterna ka qenë duke transportuar 700 000 litra të naftës. Sipas "Irna"-s, anija u konfiskua pas lëshimit të urdhrit nga organet e drejtësisë. Mediat lokale kanë

raportuar se janë ndaluar edhe shtatë anëtarë të ekipit më 31 korrik, kur edhe u konfiskua anija. Muajin e kaluar Irani ka konfiskuar një anije britanike për shkak të, siç thuhej, shkeljes

së rregulloreve për navigim. Ky veprim ndodhi disa ditë pasi Britania kishte konfiskuar një cisternë iraniane në Gjibraltari pas dyshimeve për shkelje të sanksioneve evropiane.



## Ekspertët e OKB-së: Sulmet terroriste mund të kthehen brenda 2019-s

NYU JORK, 4 GUSHT - Një pauzë në sulmet terroriste të kryera nga grupet islamike mund të përfundojë para fundit të këtij viti paralajmërojnë ekspertët e OKB-së. Monitoruesit e kombeve të bashkuara, në një raport të paraqitur në Këshillin e Sigurimit, thonë se, pavarësisht se kalifati gjeografik i të ashtuquajturit Shteti Islamik është shembur, lidhshipi i grupit po provon të adaptohet, të mbijetojë dhe konsolidohet përmes celulave të fjetura në përgatitje për një rebelim të mundshëm. Shteti islamik do të rinvestojë në kapacitetet për të drejtuar dhe kryer sulme komplekse ndërkombëtare në çastin e duhur thuhet në raport. "Mungesa aktuale e sulmeve të

tilla si pasojë nuk do të zgjasë shumë, me gjasë jo deri në fund të 2019-s. Të tjera sulme të frymëzuara nga shteti islamik do të ndodhin, ndoshta edhe në vendet ku nuk pritet", shton raporti, raporton "TCh". Ky i fundit bazohet tek informacione e siguruar nga vende anëtare të OKB-së dhe nënvizon se rreziku i sulmeve terroriste në Evropë mbetet i lartë, pavarësisht prej reduktimit të shkallës së sulmeve të suksesshme gjatë vitit të shkuar. Kontinenti i vjetër u godit rëndë në 2015 dhe 2016 kur sulmet terroriste ua morën jetën qindra personave. Në 2017-n viktimat e sulmeve terroriste u përgjysmuan. Por, potenciali për sulme të reja është i madh.



## Çekia, konsumatorja më e madhe e birrës në botë



Pragë, 4 gusht - Në Ditën Ndërkombëtare të Birrës gjermanët mund të krenohen pasi janë prodhuesi numër një të birrës në Bashkimin Evropian, me një prodhim prej 8.3 miliardë litrash, ose 21 për qind të prodhimit total të BE-së. Vendi i dytë që prodhon më shumë birrë brenda BE-së është Britania me 12 për qind të prodhimit total të bllokut, e pasuar nga Polonia, Spanja, Holanda dhe Belgjika. Italia ndërkohë e ka rritur sasinë e

birrës së prodhuar prej saj, e ndjekur nga Hungaria dhe Republika Çeke. Por, prodhimi i birrës në Britani ka rënë me 20 për qind. Mbi 39 miliardë litra birrë me alkool është prodhuar në BE, sasi kjo ekuivalente me rreth 76 litra për banor. Holanda mund të mos jetë ndër prodhuesit kryesor, por është eksportuesja më e madhe në 2018-n. Ajo ka eksportuar 1.9 miliard litra birrë, duke lënë pas Belgjikën dhe Gjermaninë.

Shtetet e Bashkuara janë destinacioni më i madh për eksportin e birrës jashtë bllokut. Në anën tjetër, Gjermania mund të jetë prodhuesja më e madhe, por nuk është konsumatorja më e madhe, të paktën jo për frymë. Sipas statistikave, Republika Çeke është vendi që ka konsumuar më shumë birrë vitin e kaluar. Austria renditet e dyta, e pasuar nga Gjermania me 100 litra për person.

## ShBA përshëndet armëpushimin në Idlib

WASHINGTON, 4 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë përshëndetur armëpushimin e shpallur në provincën Idlib në Sirinë veriperëndimore, vatra e fundit e kryengritjes në këtë vend. Departamenti i Shtetit ka paralajmëruar, përmes një

deklarate, se "sulmet kundër civilëve dhe infrastrukturës civile duhet të ndalin". Deklarata vlerëson përpjekjet e Turqisë dhe Rusisë që kanë bashkuar forcat për ta rikthyer në jetë armëpushimin e arritur vitin e kaluar. "Konflikti sirian nuk ka zgjidhje ushtarake", thonë Shtetet e

Bashkuara. "Vetëm një zgjidhje politike mund të sjellë një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt për të gjithë siriianët", thuhet në deklaratë. Që nga muaji prill qindra civilë janë vrarë në akte dhune në Sirinë veriperëndimore, mijëra të tjerë janë larguar për t'i shpëtuar dhunës.



## Indonezia në terr pas ndërprerjes së papritur të energjisë elektrike

XHAKARTA, 4 GUSHT - Kryeqyteti i Indonezisë, Xhakarta, dhe qytetet përreth janë përballur me shpërbërje të energjisë elektrike. Semaforët dhe sinjalizuesit e tjerë të trafikut janë ç'kyçur

nga energjia elektrike duke shkaktuar kaos të madh në qytetin e dendur nga trafiku. Udhëtarët në stacionet e metrove janë evakuuar pas rënies së sistemit të energjisë elektrike në tërë qytetin,

deklaruan autoritetet. Rreth 10 milionë banorë jetojnë në Xhakartë me më shumë se 20 milionë në qytetet përreth. Aeroporti Ndërkombëtar i qytetit nuk është prekur nga ndërprerja e

energjisë derisa spitalet kanë bërë zgjidhje alternative. Autoritetet deklaruan se shkaktari i ndërprerjes së energjisë elektrike është mosfunksionimi i një termocentrali.



**E jashtëzakonshme**

## Plazhi me kokoshka?

Ndodhet në Korralejo, një ishull në Fuerteventura të Spanjës, një prej ishujt Kanarie në Spanjë. Nga larg plazhi duket sikur është bërë nga gurë të bardhë, por nga afër koralet e ngordhura që i nxjerr deti ngjasojnë me kokoshkat.



## BARSOLETA E DITËS



Shefi duke e mbyllur dyqanin në mbrëmje e provokon rojën.  
 Shefi: - Roje, a e pimë nga një kafe?  
 Roja: - Jo shef, se më lë pa gjumë gjithë natën.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**FOTO E DITES**



Pamje e liqenit të Batllavës në ditët e nxehta të verës.

### Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min  
 Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




Çdo ditë në ora 17:30

### "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver  
 Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.  
 Regjia: David Leitch



**E rrallë**

## Urinon në rrugë pranë qendrës tregtare, gjobitet me 3 000 euro

Një shtetas peruan është gjobitur me 3 000 euro sepse urinoi në rrugë pranë një qendre tregtare. Peruani, emri i të cilit nuk është bërë me dije, jetonte në Milano. Në momentin që kishte urinuar burri nuk e kishte vënë re se po shikohej nga një oficer i policisë, i cili e shoqëroi menjëherë në



komisariat. Pasi iu komunikua gjoba, shtetasi peruan u largua nga komisariati pa dhënë as arsytet pse e kishte bërë gjestin.

Nga dt. 08.08.2019

### "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 orë 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Është mirë të mos komentoni shumë idetë tuaja tek persona që sapo i keni njohur. Asnjëherë nuk do të dini se si po i përdorin.



**DEMI**

Sot do t'ju duhet të jepni prova për altruizmin tuaj sidomos në raportet familjare. Do të hiqni dorë nga një gjë që e keni mjaft për zemër.



**BINJAKËT**

Keni kohë që jeni bërë viktima të konformizmit. Nëse gjërat do të ndryshojnë sot do të jetë një ndryshim për mirë.



**GAFORRJA**

Është një çështje që ju shqetëson prej kohësh dhe sot ka ardhur momenti t'i jepni fund. Gjithë ky shqetësim do të duket sikur s'ka ekzistuar.



**LUANI**

Ka projekte që ju kanë zënë shumë nga koha juaj dhe që do të kuptoni që nuk mund të realizohen. Filloni mbani distancë përpara se të jetë vonë.



**VIRGJERESHA**

Kontaktet që keni krijuar gjatë karrierës suaj do t'ju ndihmojnë të merrni një vendim që po e shtyni prej kohësh. Çdo gjë do të shkojë mirë.



**PESHORJA**

Nëse nuk doni të humbni mbështetjen e personave pranë jush duhet të jeni më prezentë në jetën e tyre dhe t'i mbështesni në çdo hap.



**AKREPI**

Keni kohë që keni qëndruar në të njëjtin vend pa bërë hapa përpara. Kjo gjendje po ju bën të ndiheni keq dhe të mbylleni në vetvete.



**SHIGJETARI**

Keni zgjedhur mënyrën për të qenë vërtet të lumtur. Jeni të mbushur me optimizëm këtë periudhë dhe kjo ju ka ndihmuar



**BRICJAPI**

Kohët e fundit keni qenë mjaft të zënë me jetën tuaj private duke lënë pas dore impenjimet profesionale. Mund të krijojë ngecje në karrierë.



**UJORI**

Sot mund të merrni vendime shumë të ndryshme nga sa keni thënë më parë. Kjo sepse në çdo moment do të keni ndryshime të situatave.



**PESHQIT**

Keni guxuar më shumë seç duhet këtë periudhë dhe sot do të jetë momenti që do t'ju duhet të merrni mbi vete të gjitha përgjegjësitë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Transferime me 'bollëk' në Superligë

100 transferime janë realizuar nga 12 skuadrat e Superligës deri tash në afatin kalimtar. Pritet që klubet elitare të bëjnë lëvizje të tjera deri në mbyllje të afatit kalimtar që përfundon më 16 gusht. Llapi është lider i transferimeve me 14 lojtarë, kurse Trepça '89 është e fundit në këtë garë me vetëm dy transferime

**EPOKA ERE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 4 GUSHT** - Më 16 gusht afati i transferimeve të futbollistëve do të përfundojë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadrat e këtij rangi garash në Kosovë nuk kanë qëndruar duarkryq dhe kanë bërë transferime të shumta ku spikat numri i madh i transferimeve nga Llapi, Ferizaj, Gjilani, por edhe skuadrat e tjera nuk qëndrojnë keq në këtë aspekt. Vlen të ceket se edhe numri i futbollistëve të ardhur nga Shqipëria është shumë i madh në krahasim me afatet kalimtare në të kaluarën.

## Feronikeli

Skuadra kampione dhe fituese e Kupës, Feronikeli, është treguar mjaft e matur në këtë afat kalimtar për faktin se ka transferuar vetëm tre futbollistë, por plani i saj për ruajtjen e lojtarëve nga edicioni i kaluar ka funksionuar për mrekulli. "Nikli" transferoi Argjend Malajn dhe Milos Krkotiqin, derisa si huazim nga skuadra e Shkupit e mori Besmir Bojku. Nga lojtarët e larguar spikasin emrat Artur Magani, Ben Hamed Kone, Alush Gavazaj dhe Berat Ahmeti.

## Prishtina

Skuadra nënkampione e Kosovës, Prishtina, e synon titullin në edicionin e ri dhe për një gjë të tillë e ka rikthyer në skuadër Ahmed Januzin dhe Endrit Krasniqin, kurse ka transferuar edhe Kreshnik Ukën, Tun Bardhokun, Alban Shillovën, Eglant Haxhon, Adem Jahajn dhe Art Malokun. Kryeqytetasit e Kosovës janë goditur edhe nga dy largime shumë të rëndësishme. Kapiteni Armend Dallku vendosi të pensionohet dhe Visar Bekaj do të transferohet

në Gjermani. Largime të tjera janë Arago Jamal, Alen Jasharoshi, Mërgim Pefqeli, Arbër Hoxha, Donat Hasanaj, Visar Bekaj, Abdul Bashiru.

## Llapi

Llapi i Tahir Batatinës duket se seriozisht do të luftojë për titull sepse ka transferuar lojtarë me përvojë si Sebino Plaku, Labinot Osmani dhe Enis Zaberxha. Transferimet e tjera janë Xhelil Abdullahi, Bruno Arrabal, Kastriot Selmani, Besfort Emini, Armin Mujkiq, Blendi Memaj, Emit Umut, Erijon Thaçi, Senad Husiq, Isein Zejnoski dhe Mërgim Pefqeli. Ndërsa skuadrën e Llapit e kanë braktisur Englant Haxho, Egzon Sinani, Ilir Blakçori, Hamdi Namani, Gentrin Begolli, Festim Alidema, Remzifaik Selmani, Miran Maksuti dhe Ahmed Januzi.

## Drita

Ish-kampionia e Kosovës, Drita, bëri transferime shumë cilësore si Hamdi Namani, Faton Maloku dhe Izair Eminin. Këtyre i janë bashkuar edhe Ilir Blakçori, Viktor Kuka, Drilon Islami, Donat Hasanaj, Darko Tofiloski, Gilberto Fortunato dhe Bunjamin Shabani. Nga ish-skuadra kampione janë larguar lojtarët që edicionin e kaluar kanë qenë titullarë të padiskutueshëm si Haxhi Neziraj, Endrit Krasniqi, Kyrian Nëabueze, Klajdi Burba, por edhe Mario Kirev, Zgjim Mustafa, Filonit Shaqiri dhe Përparim Livoreka.

## Ferizaj

Ndryshe nga skuadrat e tjera, Ferizaj transferoi shumë lojtarë, por ende nuk dihet nëse të njëjtit do të qëndrojnë apo do të largohen, sepse pronarët e rinj ende nuk e kanë përmbyllur procesin e



privatizimit të klubit dhe kontratat me futbollistët ende nuk janë nënshkruar. Transferimet e gjertanishme janë Donat Kaçiu, Dardan Jashari, Fisnik Papuçi, Ergon Hyseni, Filonit Shaqiri, Zgjim Mustafa, Taulant Dajaku, Përparim Livoreka, Fatih Karahoda, Behar Bardhi, Besart Dushi, Alban Rexhepi dhe Edon Sadriu. Ndërsa nga largimet janë Drilon Islamaj, Qëndrim Dautaj, Viktor Kuka, Genc Hamiti, Durim Gashi dhe Armend Aliu.

## Flamurtari

Flamurtari i Prishtinës realizoi dhjetë lëvizje në këtë afat kalimtar. Shtatë futbollistë janë bërë kuqezi, kurse tre të tjerë janë larguar. Festim Krasniqi, Edon Zeqiri, Torviol Stullqaku, Ernes Islami, Danin Talloviq, Gentrin Begolli dhe Erlind Selimaj do ta djersitën fanellën e skuadrës nga kryeqyteti, kurse këtë fanellë më nuk do ta djersitën Alban Shillova, Flamur Neziri dhe Florim Bërbatovci.

## Drenica

Drin Hodaj, Hasan Hyseni, Genc Hamiti, Përparim Osmani, Argjent Mustafa janë përforcimet e skuadrës tjetër kuqezi në elitë, Drenicës. Krenshnik Uka dhe Taulant Dajaku janë larguar, kurse e ardhmja e Qemail Elshani mbetet e paqartë, ani pse për "Epokën e re", "Qema" e ka konfirmuar qëndrimin në skuadrën nga Skenderaj.

## Ballkani

Aktiv është treguar edhe Ballkani i Suharekës, pasi ka bërë disa trans-

ferime interesante. Artur Magani ka vendosur që në mesin e shumë ofertave ta zgjedhë Ballkanin, kurse rrugën e sulmuesit shqiptar e ndoqën edhe Edmond Turku, Kushtrim Gashi, Arbër Hoxha, Durim Gashi, Flamur Gashi, Albin Berisha, Albin Kapra, Egzon Sinani dhe Bleron Sekiraga. Të larguarit janë Aldin Adzoviq, Dardan Jashari, Gentian Elezaj, Leart Emini, Ilir Gegaj, Leutrim Gashi, Ledjon Muçaj, Almir Ajzeraj dhe Borche Manevski.

## Trepça '89

Një prej skuadrave që ka bërë më së paku transferime është Trepça '89, e cila ka marrë Leart Eminin dhe Rron Statovcin. Nga "Riza Lushta" janë larguar Elton Basriu, Ergys Mersini, Orges Gava, Renato Hyshmeri dhe Hasan Hyseni.

## Gjilani

Qëndrim Dautaj është rikthyer në Gjilan pas një kohe të gjatë, kurse derisa kësaj skuadre i janë bashkangjitur edhe Shkëlqen Ruçi, Erlis Frashëri, Oltion Rapa, Jackson Ferreria, Muhamet Useini, Bedri Greca, Gerhard Progni dhe Tomislav Busiq. Nga Gjilani janë larguar Vilfor Hysa, Shpend Asani, Kledi Koci, Donat Kaçiu, Endrien Magani, Vilson Lila, Fisnik Papuçi, Jefferson Lopes, Semir Hadzibulic, Ansi Nika, Qëndrim Ismajli & Arlind Ismajli.

## Vushtrria

Vushtrria është skuadra që doli kampione në Ligën e Parë dhe afati kalimtar ka qenë mjaft i fuqishëm nga ky klub që pretendon të ketë stabilitet në

Superligë. Kujtim Pantina, Besfort Dervishaj, Rinor Karaqa, Petrit Tahiri, Qëndrim Gashi, Bashkim Shala, Enes Manxholli, Ledjon Muçaj, Jasmin Rraboshta, Klevis Lushaku janë përforcimet e Vushtrisë, kurse nga ky klub janë larguar Labinot Osmani, Korab Hasani, Kastriot Selmani, Leutrim Kadriu, Eugen Rafuna dhe Alban Rexhepi.

## Dukagjini

Dukagjini pas shumë vjetësh është rikthyer në Superligë. Skuadra nga Klina ka bërë disa transferime mjaft interesante, pasi në radhët e veta do të ketë lojtarë me përvojë të madhe si Elton Basriu, Ilir Mustafa, Altik Muhaxhiri, Jeton Dushi, Ilir Syla, Altin Lloga, Denis Haliti, Flamur Neziri dhe Husein Demiri. Tre lojtarë e braktisën këtë klub: Edmond Turku, Endrit Elezaj dhe Dukagjin Gashi.

## Kosova mposhti Luksemburgun

**PRISHTINË, 4 GUSHT** - Basketbollistët e Kosovës U18 e kanë përfunduar me fitore Kampionatin Evropian, Divizioni B, që të dielën përfundoi në Rumani. Në ndeshjen për vendin e 23-të, "Dardanët" e rinj e kanë mundur Luksemburgun me rezultat 67:49. Bardh Rexha ka qenë i jashtëzakonshëm me 20 pikë dhe 14 kërcime, derisa është ndihmuar nga Albin Berisha dhe Donat Musa me nga dhjetë pikë. Ky Evropian ishte një përvojë e mirë për basketbollistët e Kosovës që si synim kishin të fitojnë përvojë në gara të tilla.



## Feronikeli: Nuk kemi pasur kontakte me Sokolin dhe Maganin

**DRENAS, 4 GUSHT** - Skuadra e Feronikelit e ka mohuar se është në bisedime me trajnerin Bylbyl Sokoli. Kampionët e Kosovës mohimin e njëjtë e bënë edhe për trajnerin nga Shqipëria, Gugash Magani. "KF Feronikeli

hedh poshtë spekulimet e medieve kinse është arritur marrëveshje në mes të klubit tonë dhe trajnerit Bilbil Sokoli, madje as që kemi biseduar me të. KF Feronikeli sqaron opinionin se është afër marrëveshjes

me një trajner të huaj dhe shpejt pritët zyrtarizimi i tij. Lusim mediet se para se të plasojnë lajme të marrin informacione nga klubi i cili është i hapur për të gjithë të interesuarit", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

Në lidhje me mohimin për kontakte me trajnerin Magani në faqen e "Niklit" shkruan: "KF Feronikeli e konfirmon që nuk ka pasur asnjë lloj kontakti me asnjërin prej dy trajnerëve të njohur".



## Marquezi triumfon në Çeki

BRNO, 4 GUSHT - Marc Marquez ka dominuar edhe në Brno. Piloti spanjoll ka fituar Çmimin e Madh të Çekisë, gara e dhjetë e Botërorit të MotoGP, dhe ka thelluar akoma më shumë dallimin me ndjekësit e tij në

renditje. Marquez e ka nisur garën nga vendi i parë dhe ka qëndruar në krye nga kthesa e parë deri tek ajo e fundit, duke iu rezistuar sulmeve të Andrea Dovizioso, i cili ka bërë një start të mirë dhe ka marrë vendin e

dytë, të cilin e ka mbrojtur deri në fund. Podiumi është kompletuar nga Jack Miller, i cili ka befasuar në fund një Alex Rins në vështirësi. E ka mbyllur në vendin e gjashtë garën Valentino Rossi.



## Superkupa i takon Cityt



MANCHESTER, 4 GUSHT - Sezoni në Premier Ligë nisi sot zyrtarisht me Superkupën e Anglisë, mes fituesve të titullit, Manchester Cityt dhe fituesve të Ligës së Kampionëve, Liverpoolit, që sfiduan për këtë trofe djemtë e drejtuar nga Pep Guardiola, pasi u renditën në vend të dytë. Nuk mjaftuan 90 minuta për ta shpallur fituesin dhe

përcaktuar se kujt do t'i shkonte trofeu, por u deshën penalltitë. Megjithatë, ata 90 minuta treguan jashtëzakonisht shumë dhe mund të ishin mbyllur me më shumë se dy gola. Dy herë goditi shtyllën Liverpool, dy raste të pastra pati Sterling, teksa pikërisht anglezi shënoi golin e parë për Cityn. Barazoi Matip me kokë, ndërsa

Salah pati disa çaste të mira, duke vënë në provë një super Claudio Bravo. Por, mrekullia në fund erdhi nga Walker, që me një gjysmërove-shatë i tha "jo" Salahut, që ishte gati për ta festuar golin e fitores dhe të trofeut. Te penalltitë, vendizv gabimi i Winajldum, me superpritjen e Bravos. Të gjithë shënuan më pas.

## Hamiltoni triumfoi në Hungari, Vetteli i treti

BUDAPEST, 4 GUSHT - Piloti Lewis Hamilton fiton Çmimin e Madh të Hungarisë në Formula 1 pas një parakalimi vendimtar ndaj Max Verstappen katër xhiro nga fundi i garës. Strategjia e Mercedesit rezultoi e përkryer, pasi me një "pit-stop" më shumë i dhuroi suksesin britanikut para holandezit të Red Bullit, që kishte fituar "pole-position" e parë në karrierë. Një paraqitje për t'u harruar e Ferrarit, që arriti të ngjitet në podium vetëm me Sebastian Vettelin në vendin e tretë, ndërsa Leclerc e kaloi vijën e finishit pas pilotit gjerman. Dy njëvendëshet "kokëkuqe" nuk ishin në asnjë moment në garë për suksesin, madje përfituan në fillim nga starti i tmerrshëm i Valtteri Bottas. Carlos Sainz me McLarenin e tij e u rendit i pesti, para Red Bullit të Pierre Gasly.



Vendi i shtatë për Kimi Raikkonenin mbi Alfa Romeo, më pas Valtteri Bottas, që arriti të

rikuperonte disa vende, Lando Norris (McLaren) dhe Alexander Albon (Toro Rosso).

## Roma e ngre çmimin e Dzekos

Roma e ka ngritur çmimin për sulmuesin Edin Dzeko në 20 milionë euro plus bonuse në një përpjekje për ta larguar interesimin e Interit. "Nerazzurri" kanë rënë dako-

rd për kushtet personale me boshnjakun, i cili pëlqehet nga trajneri Antonio Conte. Oferta e Interit ishte 12 milionë euro plus tre milionë bonuse, por kërkesa e Romës është 20 mil-

ionë euro. Sipas gazetës "La Repubblica", Roma, tani, përveç çmimit të kërkuar prej 20 milionë eurosh, ka shtuar edhe bonuset që lidhen me performancën.

### SHKURT

#### Privatizohet KF Vushtrria

Kuvendi Komunal i Vushtrrisë ka votuar unanimisht për privatizimin e klubit të futbollit, Vushtrria. Tani e tutje KF Vushtrria është klub privat, ndërsa pronar i saj është Bajrush Kajtazi. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e klubit vushtrrias. "Në kuvendin e rregullt të Klubit FC Vushtrria, i mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, kuvendarët e klubit unanimisht votuan pro privatizimit të klubit, me pronar të ri Bajrush Kajtazi, pronar i firmës UNION sh.p.k", thuhet në njoftimin e klubit.

#### Veseli largohet nga Empoli, shkon në Turqi

Frederik Veseli i ka dhënë fund aventurës trevjeçare me skuadrën e Empolit. Portali i njohur italian "gianlucadi-marzio.com" raporton se destinacioni i ri i mbrojtësit shqiptar do të jetë skuadra e Superligës turke Denizlispor. Gjatë tre vjetëve të tij tek Empoli, Veseli ka qenë pjesë e rregullt e formacionit titullar të skuadrës toscane. Kontrata e 26-vjeçarit me Empolin mbaron pas dy sezonesh, por kjo gjë nuk është bërë pengesë për realizimin e këtij transferimi. Veseli është një ndër përforcimet e shumta që klubi Denizlispor ka realizuar gjatë këtyre javëve. Pas nëntë vjetësh qëndrim në Ligën e Parë, drejtuesit e klubit po bëjnë maksimumin që qëndrimi i tyre në elitën e futbollit turk të jetë sa më jetëgjatë.

#### Bennaceri në Milan

Tashmë është zyrtare. Ismael Bennacer është lojtari më i ri i Milanit. Klubi kuqezi nëpërmjet një deklaratë ka prezantuar mesfushorin e ardhur nga Empoli. Algjeriani, që u shpall kampion i Afrikës pak ditë më parë, vjen nga Empoli, pas një sezoni mjaft të mirë, ku u aktivizua në plot 37 takime. 21-vjeçari, që luan para mbrojtjes, ka firmosur një kontratë pesëvjeçare, që e mban lidhur me "Djallin" deri në vitin 2024, ndërsa paga e tij do të jetë 1.5 milion euro në sezon.

#### Evertoni zyrtarizon Keanin

Moise Kean është zyrtarisht një lojtar i Evertonit. Sulmuesi i datëlindjes 2000 është larguar nga Juventusit për të nisur një aventurë të re me "Toffees", që ka vendosur ta ndërtojë sulmin rreth yllit italian. Në arkat e Juventusit kanë shkuar 30 milionë euro, plus bonuse, ndërsa lojtari ka nënshkruar një kontratë pesëvjeçare. Ai ka qenë vendimtar në titullin e fundit të fituar nga bardhezinjtë në Itali me 6 golat e realizuara në 13 ndeshjet e luajtura.

